

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 81, datë 29.07.2024

PËR MIRATIMIN E DISA SHTESAVE NË ANEKSIN 1, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 178, DATË 01.12.2023 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 3, RRUGA "STEFAN DHIMA" PALLATI NR. 8, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019"

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 05.03.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale", Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr.104, datë 08.07.2022, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, Raportit me nr.8542/1 prot., datë 19.07.2024 të Komisionit të Posaçëm miratuar nga kryetari i bashkisë, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e disa shtesave në Aneksin 1, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 178, datë 01.12.2023 përsa i përket listës së përfituesve për pallatin nr.8, rruga “Stefan Dhima”, në Njësinë Administrative nr.3, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, si më poshtë vijon:


Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
10	AGRON JUPE, SHKENDIJE JUPE	4	2+1
11	ASTRIT MARISHTA, NATASHA MARISHTA	4	2+1
12	GJENC BALLANCA, LIMAN BALLANCA	2	1+1
13	MUHAMET MEMA, TEUTA MEMA	4	2+1
14	EDUARD ALLAMANI	2	1+1
15	DRINI ZENELI, ARBORA ZENELI	3	2+1
16	AGRON XHAFERI, DANIELA XHAFERI	3	2+1
17	FLUTURA BITRA, KLODJANA BITRA	4	2+1
18	JULIANA COBANAJ	3	2+1
19	ALTIN KAZAZI, RIZA VAROSHI, SUADA KAZAZI, SUZANA VAROSHI	2	1+1

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.07.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës


Nr. 44/11 prot.

Durrës, më 01.08.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr.81 datë 29.07.2024 “Për miratimin e disa shtesave në aneksin 1, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 178, datë 01.12.2023, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në njësinë administrative nr.3, rruga "Stefan Dhima", pallati nr.8, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019 ”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

